



Nr. 57 prc  
Dt. 16/08/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 2 Datë 14. 08. 2018

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI  
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “HEC ARSTI” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 42, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 dt.15.11.2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, të kontratës konçesionare të formës BOT (nr. 1129 Rep. Nr.351/1 Kol, datë 25.05.2016 si dhe të kontratës shtesë të konçesionit (Nr.2785 Rep. Nr. 1308/3 Kol., datë 14.12.2017), për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “HEC ARSTI” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit “HEC ARSTI” sh.p.k. me administrator Z.LUSH OSMANI, për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Arstit (Meziut)** për prodhim energjie elektrike në fshatin Arst, Njësia Administrative Fierz, Bashkia Fushë -Arrëz, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC ARSTI** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes nr 1:	$X_1 - 44\ 25\ 003.272;$	$Y_1 - 46\ 73\ 411.12;$	$Z_1 - + 605\ m;$
Koordinatat e veprës së marrjes nr.2:	$X_2 - 44\ 25\ 514.389;$	$Y_2 - 46\ 73\ 400.165;$	$Z_2 - + 605m;$
Koordinatat e veprës së marrjes nr.3:	$X_3 - 44\ 25\ 710.102;$	$Y_3 - 46\ 73\ 513.143;$	$Z_3 - + 605m;$
Koordinatat e godinës së centrali:	$X - 44\ 26\ 881.366;$	$Y - 46\ 75\ 387.31;$	$Z - + 300m;$
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	$X - 44\ 26\ 881.366;$	$Y - 46\ 75\ 387.31;$	$Z - + 300m;$
Prurja mesatare vjetore e burimit:	$Q_1\ mes/vj= 0.737\ m^3/sek;$	$Q_2\ mes/vj=$	$Q_3\ mes/vj=0.057\ m^3/sek;$
Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret:	$Q_1\ llog = 1.24\ m^3/sek;$	$Q_2\ llog =$	$Q_3\ llog = 0,08\ m^3/sek;$
Prurja ekologjike:	$Q_{1ekol} = 0.152\ m^3/sek;$	$Q_{2ekol} =$	$Q_{3ekol} = 0.012\ m^3/sek;$
Prurja që shkarkohet:	$Q = 1.4\ m^3/sek.$		

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR  
Raimonda GURI



KRYETAR  
Cesk MILLJA

